

VENDIM
Nr. 36, datë 27.1.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 764, DATË 7.11.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BILISHT, TË QARKUT TË
KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në titull dhe në përmbajtje të vendimit, fjalët “... Bashkia Bilisht ...” zëvendësohen me “... Njësia Administrative Bilisht, Bashkia Devoll ...”.

b) Në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit, të dhënat e pasurive 1/7 dhe 1/8, të llojit “truall”, me vendndodhje në zonën kadastrale 1187, të ndryshojnë sipas formularit gjithsej 1(një) fletë dhe hartave kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

c) Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit, pasuritë e përcaktuara në shkronjën “b”, të kësaj pike, të transferohen në pronësi të Bashkisë Devoll, për Njësine Administrative Bilisht, me qëllim për t’u përdorur në fushën e strehimit dhe të shërbimeve sociale.

2. Bashkisë Devoll i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Bashkia Devoll dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

HARTE KADASTRALE (Fragment)

